



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

DEPARTAMENTI I LIGJOR/LEGAL DEPARTMENT/ZAKONODAVNI DEPARTMENT

Në përputhje me Nenin 1 paragrafi 1.3 Pika (ç) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit për Organizatat Jo Qeveritare në Kosovë, si dhe dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Me qëllim të përkrahjes financiare të zyrave të OJQ-ve, fushëveprimi i të cilave ndërlidhet me fushëveprimin e MPMS-së, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.04/2008
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
Nr.01/2008
PËR OFRIMIN DHE SIGURIMIN E PËRKRAHJES FINANCIARE TË OJQ-ve
VENDORE GJATË VITIT 2008

Neni 1

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ Nr.01/2000 për arsye të paraqitjes së nevojës për tu ofruar ndihmë financiare edhe disa OJQ-ve, fushëveprimi i të cilave ndërlidhet me atë të MPMS-së

Neni 2

Neni 2 i Udhëzimit Administrativ 01/2008, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin vijues:

Me qëllim të realizimit të projekteve të caktuara që ndërlidhen me fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkrahje financiare mujore për vitin 2008 nga mjetet buxhetore të kësaj Ministrie do të përfitojnë këto OJQ:

- Shoqatat e dalura nga lufta.....8000 € në muaj
- Shoqata e të burgosurve politik.....500 € në muaj
- Sindikata e pensionistëve të Kosovës.....500 € në muaj
- Shoqata e të verbërve700 € në muaj
- Shoqata e Gruas “VITA”165 € në muaj
- Lidhja e Shoqatave Komunale të Pensionistëve të Kosovës.... 750 € në muaj
- OJQ “Fëmijët Kosovar dhe Evropian dhe të drejtat e tyre KECHR”500 € në muaj
- OJQ “Thirrjet e Nënave” ... 700 € në muaj
- “UNIJA” Gracanica + 5 NGO.....1000 € në muaj
- Lidhja e invalidëve civil të luftës në Kosovë700 € në muaj
- Organizata e Invalidëve të Punës të Kosovës (OIK).....500 € në muaj
- Shoqata e personave me paralizë të fëmijëve “Handicap Kosova”.....500 € në muaj
- OJQ “Komunikimi për zhvillimin e Shoqërisë-CSD”, Graçanicë3000 € në muaj
- OJQ “Bashkimi i Invalidëve-Graçanica”, Graçanicë.....500 € në muaj
- Caritasi i Kosovës.....1000 € në muaj

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ është aneksi i Marrëveshjes së Mirkuptimit Nr.462 i datë 25.02.2008, i cili do të pasoj pas nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 4

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga 1 janari 2008.

Prishtinë, mars 2008

**Ministri i MPMS-së
Nenad Rashiq**